



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:248228

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05708537

Ac.nr.899/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Faton Ademi - Kryetar i kolegjit, Hidajete Gashi Alaj dhe Besnik Bislímaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.I., nga Istogu, me banim në Prishtinë, Rr..., Blloku ..., nr..., të cilin me autorizim e përfaqëson F.M., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës “G...E...” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. “...”, Nr..., të cilën e përfaqësojnë A.K. dhe G.V., avokatë në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit për shkak të shpifjes dhe fyerjes, duke vendosur në lidhje me ankesën e paditësit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.705/17, i datës 01.12.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit N.I. nga Istogu, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.705/17, i datës 01.12.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.705/17, i datës 01.12.2021 ka vendosur si në vijim:

“I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit N.I., nga Istogu, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material për shkak të humbjes së vendit të punës në shumë prej 4,000.00€, dëmin jomaterial – dëmtimin e integritetit personal për shkak të publikimit të informacionit se paditësi ka qenë i dënuar gjë që ka ndikuar në reputacionin e tij në shumën prej 4,000.00 €, dhe dëmin jomaterial – dhimbja shpirtërore si pasojë e publikimit të cilin paditësi e ka pasur e fëmijun e tij të vetëm në shumë prej 2,000.00€, apo shumën e përgjithshme prej 10,000.00 € pa përfshirë kamatën ligjore dhe shpenzimet.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale ”

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur paditësi për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimi i atakuar të ndrvshohet ashtu që të pranohet në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material për shkak të humbjes së vendit të punës në shumë prej 4.000.00 € , dëmit jomaterial — dëmtim e integritetit personal për shkak të publikimit të informacionit se paditësi ka qenë i dënuar gjë që ka ndikuar në reputacionin e tij në shLl më prej 4.000.00 €. dhe dëlin jo-material chimbje shpirtërore si pasojë e publikimit të cilin paditësi ka pasur me fëmiun e tij të vetëm në shumë prej 2.000.00 €, apo shumë e përgjithshme prej 10.000.00 ose që aktgjykimi i ankimuar të prishet dhe çështja t'i kthehet të njëjtës givkatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në padi

Gjykata e Apelit si Gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datën me datë 23.03.2017, ka parashtruar padi për shpifje dhe fyerje, kundër të paditurës “G...E...”, Sh.p.k, me seli në Prishtinë, më konkretisht me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.705/17, i datës 01.12.2021 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, Gjykata e shkallës së parë në këtë çështje juridike nuk ishte kontestues fakti se e paditura në portalin e saj në faqen e internetit www...com, me datë 29.01.2017, kishte publikuar një shkrim me titull “*Presidenti dhe Kryeministri s’thonë asnjë fjalë për dorëheqjen e shefit të AKI’së*”. Kontestuese mes palëve ishte baza juridike e kërkesëpadisë, respektivisht nëse pjesë të artikullit që ishin objekt kontesti kanë përmbyjtje shpifëse dhe fyese ndaj paditësit – gjë që do të ishte bazë për kompensimin e dëmit. Nga artikulli i lartcekur, Gjykata gjeti se e paditura e dytë me qëllim të dhënies së informatave dhe nxitjes së një teme që ishte në interes publik, kishte publikuar një shkrim me datë 29.01.2017, që lidhej me temën e dorëheqjes së shefit të AKI-së A.S. nga kjo pozitë. Ne mesin e arsyeve që gazeta i konsideronte se kishin çuar në dorëheqjen e shefit të AKI-së, ishin dyshimet për keqpërdorime, për të cilat artikulli i referohet “raportimeve të mediave”. Në këtë kontekst e paditura, në artikullin kontestues, thekson se “*personi që e ka denoncuar S... është ka probleme ligjore pasi është i dënuar dhe kishte shkelur edhe një fëmijë me veturë*”.

Duke qenë se paditësi pretendon se me këtë konstatim e paditura ka shpifur ndaj tij, përmes emailit të datës 29.01.2017, ka parashtruar kërkesë te e paditura për të demantuar thëniet në lidhje me shkrimin e datës 29.01.2017. Nga vendimi i AKI me nr.prot.175/2017 i datës 01.06.2017, u vërtetua fakti se punëdhënësi AKI i kishte shqiptuar paditësit masë disiplinore “ndërprerje të marrëdhënies së punës” dhe i kishte ndërprerë kontratën e punës. Nga vërtetimi i Policisë së Kosovës me nr. rendor SIPK-Q-2678/19 i datës 28.10.2019, Gjykata ka vërtetur faktin se paditësi nuk ka dosje penale në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës. Po ashtu, nga Certifikata e Gjykatës Themelore në Pejë – Dega Istog, nga evidenca penale e datës 01.10.2019, vërtetohet

fakti se ndaj paditësit nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe nuk është i dënuar penalisht. Nga Fletë lëshimi i QKUK i datës 06.08.2015 me numër amzë 6046, u vërtetua fakti se fëmija i mitur i paditësit ishte pranuar në QKUK – Klinika e Kirurgjisë Pediatrike me datë 03.08.2015 për shkak të lëndimeve të marra nga automjeti (fëmijën e kishte goditur vetura nga prapa dhe është futur nën veturë).

Gjykata për vendosje ka zbatuar dispozitat e Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes – LCSHF (Ligji Nr. 02/L-65, konkretisht nenet 3, 5, 182, si dhe nenin 40 të Kushtetutës së Kosovës lidhur me nenin 10 të Konventës Evropiane Për të Drejtat e Njeriut.

Lidhur me këtë, Gjykata gjen se në rastin konkret, nisur nga fakti se shefi i Agjencisë së Inteligjencës kishte dhënë dorëheqje nga pozita, kjo medoemos paraqiste një temë me interes publik, për të cilën e paditura kishte raportuar në artikullin kontestues. Në këtë artikull, ku shtrohet çështja e dorëheqjes së shefit të AKI-së, e paditura i referohet raportimit të mediave – sipas të cilave, dyshohet se shefi i inteligjencës ishte larguar për shkak të disa keqpërdorimeve. Në trajtimin e kësaj teme, e paditura aludon se shefin e AKI-së e kishte ‘denoncuar’ një person që ka probleme ligjore pasi ishte dënuar dhe kishte shkelur edhe një fëmijë me veturë. Kjo edhe ishte objekt i këtij kontesti, pasi që paditësi pretendonte se e paditura kishte dhënë informata jo të vërteta, me c’rast kishte shpifur ndaj tij. Gjykata vlerëson se përmbajtja e artikullit nuk ka të bëjë fare me paditësin, ngase i njëjti nuk përmendet në cilësi personale, as përmes inicialeve, apo në ndonjë formë tjetër e cila mund ta sjellë para identifikimit nga ana e publikut. E paditura, e përmend “personin”, vetëm në kontekst të “denoncuesit” të shefit të AKI-së, por pa e përmendur me emër. Së këndejmi, nuk mund të bëhet fjalë për dëmtim të reputacionit të paditësit, për faktin se i njëjti në asnjë formë nuk është bërë i ditur për publikun e as nuk ka mundur të jetë i identifikueshëm. Më tej, Gjykata vë në pah faktin se paditësi ka qenë i punësuar në Agjencinë e Inteligjencës, e cila është organizatë me karakter dhe veprimtari të klasifikuar, ndërsa paditësi ka pasur status të një zyrtari konfidencial. Në këto rrethana, paditësi jo vetëm se nuk bie në kategorinë e personave publik, por me statusin e tij si punonjës i inteligjencës nuk ka qenë as i identifikueshëm për publikun. Përkundrazi, ka qenë vet paditësi i cili në shqyrtimin gjyqësor ka pohuar se me datat 01.09.2016, 19.09.2016 dhe 01.10.2016, i është drejtuar Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit dhe Presidentit, duke raportuar me shkrim për shkeljet në drejtim të tij. Nga kjo rrjedh se e paditura nuk mund të mbahet përgjegjëse për shpifje, pasi që jo vetëm se nuk e ka bërë të identifikueshëm paditësin përmes shkrimit të saj, por raportimi nga burimet që ka pasur gazeta asocion pikërisht me denoncimin e bërë ndaj shefit të AKI-së. Ndonëse me raportimin e të paditurës, paditësi e ka identifikuar veten, Gjykata nuk mund ta trajtojë artikullin kontestues në kontekst të shpifjes ndaj tij. Kjo për faktin se paditësi në asnjë formë nuk ka mundur të jetë i identifikueshëm për publikun, e në veçanti nga fakti se paditësi në shqyrtimin gjyqësor ka pohuar se ka ndërmarr veprime në drejtim të denoncimit të shefit të AKI-së – nga ku rrjedh se e paditura ka pasur një bazë faktike për raportimin e saj, bazuar në burimet që ka pasur. Për më tepër, vet paditësi ka deklaruar se ky artikull ka qenë vazhdimësi e shkrimeve të tjera ndaj tij, siç ishte ai i datës 26.01.2017 në portalin “i...”. Rrjedhimisht, e paditura ka raportuar edhe mbi bazën e lajmeve nga mediat tjera.

Tutje Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në rastin konkret, Nga provat e administruara, qëndron fakti se paditësi ka paraqitur në Gjykatë prova se nuk ka qenë i dënuar apo i ndjekur penalisht. Megjithatë, Gjykata vlerëson se shpifja e pretenduar nuk mund të gjykohej nga përpjekja për të gjetur lëshimet formale të dokumentuara me prova brenda një artikulli gazetaresk, por duhet të vlerësohet në dritë të raportimit të lajmit për informim të drejtë të publikut. Siç u theksua më sipër, Gjykata nuk ka gjetur asnjë element shpifës në drejtim të

personalitetit të paditësit si individ, pasi që edhe në këtë fazë i njëjti mbetet i pa identifikueshëm. Për më tepër, në rrethanat e raportimit të rastit nuk mund të pritej që e paditura të siguronte saktësinë e plotë të informacioneve në kohë të shpejtë nga burimet e saj. Duke marrë parasysh rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se për gazetarët nuk është gjithnjë e mundur që në momentin që lajmi botohet të pritet vërtetësia e fakteve me prova konkrete, por mjafton që lajmi të ketë një bazë të arsyeshme faktike. Kur bëhet fjalë për pretendimet e paditësit për konstatime të pavërteta të paditurës, Gjykata përsërit se i njëjti ka qenë zyrtar sekret i inteligjencës, për të cilin e paditura nuk pritej ta kontaktonte për të konfirmuar faktet. Gjykata gjen se edhe nga provat e ofruara nga paditësi – flet lëshimet e spitalit për fëmijën e tij të mitur, rezulton se fëmijën e kishte goditur vetura nga prapa dhe është futur nën veturë. Ndërsa, paditësi në shqyrtimin gjyqësor ka pohuar se ka pasur aksident me fëmijën e tij. Këto fakte për Gjykatën nuk janë të qarta - nëse kemi të bëjmë me të njëjtin aksident të cilin e pohon paditësi – gjë që deri në një masë përputhet me raportimin e gazetës, apo kemi të bëjmë me raste të ndryshme. Sido që të jetë, kjo paraqet vetëm një argument për të sqaruar vështirësinë e të provuarit të fakteve nga vet paditësi, e që nuk mund të pritet të ndriçohet nga gazeta. Në vlerësimin e Gjykatës, pretendimi i paditësit se ka përjetuar dhimbje shpirtërore qoftë për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës apo edhe për shkak të shkrimeve në media, nuk paraqet bazë për shpërblimin e dëmit. Në mënyrë që e paditura të mbahet përgjegjëse për dëmet, duhet të ekzistojë ndër të tjera edhe lidhja kauzale në mes të veprimit të kundërligjshëm dhe dëmit të shkaktuar. Në një gjendje të këtillë faktike, Gjykata nuk mund të pranojë pretendimin se shkrimet e të paditurës në portal, kanë qenë shkaktar i procedurave disiplinore të paditësit, ngase me asnjë provë nuk vërtetohet një lidhje e tillë kauzale. Qoftë edhe nëse paditësi ka pësuar me ndërprerje të marrëdhënie të punës, nuk mund të mbahet përgjegjëse e paditura për një procedurë të marrëdhënies së punës.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka konstatuar gjendjen faktike dhe rrjedhimisht e drejta materiale është aplikuar drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Po ashtu, Gjykata ankimore vlerëson se Gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, nga e cila ka rezultuar se shkrimet e pretenduara nga pala paditëse janë botuar nga e paditura, mirëpo në shkrimet për të cilat paditësi pretendon se kanë përmbajtje shpifëse për të rezultojnë se në ato shkrime nuk identifikohet paditësi si person nuk përmendet emri i paditësit si person apo ndonjë e dhënë tjetër si datëlindja, numri personal, mirëpo paditësi pretendon se personi në fjalë i apostrofuat me elementet tjera rrethanore si aksidenti me veturë është pikërsiht ai. Procedurat e brendshme brenda Agjencisë Kosovare për Inteligjencë janë procedurë strikte konfidenciale dhe publiku ka qasje të kufizuar për shkak të natyrës së punës që merret kjo agjenci. Paditësi përmes padisë kërkon kompensim nga të paditurat për shpifje ndaj tij, ndërsa të paditurës gazetës “E...” i është drejtuar në procedurë administrative me demant që po ashtu ka kërkuar që edhe me rastin e demantit të mos publikohet identiteti i tij, për shkak të konfidencialitetit.

Me Ligjin Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes ipen nocionet e shpifjes dhe fyerjes, nga i cili ligj shpifja definohet si: *“Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër.”*, ndërsa fyerja definohet si: *“Fyerja nënkupton*

deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese.”

Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike nga e cila gjendje ka rezultuar se të paditurat nuk kanë kryer shpifje apo fyerje në drejtim të paditësit, sepse në ansjë mënyrë nuk mund të identifikohet nga shkrimet se të njëjtat përmendin paditësin qoftë me emër dhe mbiemër, cilësitë personale të tij, apo në ndonjë formë tjetër, që rezulton se publiku nuk do të mund t’ a identifikonte përmes atyre elementeve që paditësi I përmend se bëhet fjalë për të njëjtin. Pra tek shpifja dhe fyerja pala paditësie duhet të jetë e identifikueshme përndryshe nuk plotësohen as kushtet e shpifjes e as fyerjes, sepse kusht është personi të jetë I identifikueshëm personi të cili I adresohet shkrimi dhe identifikimi I tij duhet të jetë I lehtë për publikun përmes të dhënave personale të tij, përndryshe çdo I treti person mund të aludojë se është ndjerë i shpifur apo fyer nga një shkrim në gazetë sepse janë përmend disa cilësi që I posedon.

Pra gjendja faktike e vërtetuar nga ana e Gjykatës së shkallës së parë rezulton edhe nga ana e Gjykatës së Apelit të jetë vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, pasi nga ekzaminimi dhe vlerësimi I provave të administruara nga ana e Gjykatës së shkallës së parë rezulton se nuk plotësohen elementet e shpifjes dhe fyerjes, në shkrimet e publikuara nuk përmendet emri dhe mbiemri I paditësit e as ndonjë e dhënë personale, ndërsa aludimi në cilësi nuk është I mjaftueshëm për tu kualifikuar se të paditurat kanë bërë shpifje në drejtim të paditësit.

Poashtu në shkrimet e të paditurave fokusi ka qenë tek drejtori i AKI-së si person dhe dorëheqja e tij për shkak të interes publik për tu informuar sepse bëhet fjalë për njërin ndër personat shumë të rëndësishëm në Institucionet e Kosovës, duke marrë për bazë veprimtarinë që merret AKI-ja dhe sigurinë e përgjithshme të qytetarëve.

Kualifikimi I shkrimeve të të paditurës si shpifje dhe fyerje në një format të tillë, do të përbente cenim të sigurisë juridike të gazetarëve dhe shkatërrim të klimës së informimit dhe Lirisë së Shprehjes si bazamente të një Shteti Demokrat.

Paditësi nuk ka qenë në gjendje të provojë as shpifjen e as fyerjen sepse këto dy kategori nuk janë të njëjta sikurse u cek më lartë definicioni për të dyjat, pra lajmet e publikuara paditësi I ka kualifikuar edhe si shpifje edhe si fyerje gjë që nuk mund të qëndojnë sepse shpifja është një publikim I një fakti apo deklarate të pavërtetë etj... ndërsa fyerja ka të bëjë me deklarin apo publikimin e deklartës së drejtuar një personi tjetër e cila është nënçmuese por që nuk do të thotë se është e pavërtetë.

Në rastin konkret edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, sepse për të pasur të drejtë paditësi në kompensim duhet të vërtetohet fakti se ndaj paditësit e paditura ka shpifur apo fyer. Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si udhërrëfyes për praktikën gjyqësore në përgjithësi dhe në rastet e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe shpifjes e fyerjes në veçanti, përcakton standard të të provuarit në të kundërtën sikurse u cek më lartë, secili vendim I Gjykatës për kompensim duke u bazuar në aludime dhe hamendësime të qytetarëve se një lajm ka qenë I drejtuar kundër të tij në bazë të disa elementeve duke përjashtuar të dhënat e identitetit të tij është bazë e pa mjaftueshme për të ardhur në përfundim se kemi shpifje. Në rastin e Reznik kundër Ruisë GJEDNJ-ja ka vë në pah elemente përjashtuese nga shpifje dhe fyerja që ka elemente të përbashkëta me paditësin ku ka theksuar

se: *“hamendësimi thjeshtë persona ose përceptimi subjektiv I një publikimi si shpifës nuk mjafton për të vërtetuar se personi ishte prekur drejtpërdrejt nga publikimi. Duhet të ketë diqka në rrethanat e një rasti konkret që ta bëjë një lexues të zakonshëm të ndierë se deklarata reflektohet drejtpërdrejt tek pretenduesi individual ose se ai ishte në shënjestër të kritikës”*. Kjo përcakton standardet minimale për lidhjen në mes të shkrimit dhe personit, pra kërkohet që lexuesi i zakonshëm të identifikojë nga shkrimi se kush është personi të cilit I adresohet shkrimi. Në rastin konkret jo lexuesi I zakonshëm dhe pothuajse shumica e lexuesve nuk kanë pasur asnjë mundësi të bëjnë identifikimin në mes të lajmit të publikuar dhe personit të “apostrofuar” përmes të dhënave përkatëse. Është një praktikë tashmë e krijuar nga ana e GJEDNJ-së që në raport me gazetarët dhe mediat, të njëjtave iu lejohet tejkalimi I kufijve të caktuar me rastin e shkrimeve dhe publikimeve krejt kjo bazuar në punën që kryejnë rëndësine e informacionit për publikun dhe informimin e publikut, interesit të përgjithshëm për figura apo personalitet publike por jo edhe në raport me ndjerëzit e rëndomtë. Kjo praktikë është ndërtuar mbi bazën e disa qëllimeve të ligjshme e që janë garantimi i lirisë së shprehjes dhe e drejta e informimit, heqja dorë nga disa të drejta private nga syri i publikut i personaliteteve që mbajnë apo ushtrojnë pozita funksione publike.

Në rrethanat e rastit konkret e paditura në asnjë rrethanë nuk ka mundur të kontaktojë paditësin e as që ka pasur detyrim sepse nuk ka përmendur të dhënat personale, ndërsa funksioni I paditësit ka qenë i tillë si funksion sekret dhe jo I njohur për publikun, qëllimi I palës së paditur justifikohet nën dritën e interesit të publikut për informim sepse dorëheqja e kreut të AKI-së në secilin shtet do të pasonte me lajme bombastike që jo gjithmonë është e lehtë për t’u vërtetuar vërtetësia e tyre, pra qëllimi I palës së paditur ka qenë që dorëheqja e kreut të AKI-së si institucioni më I rëndësishëm në fushën e sigurisë, ka ardhur nga problemet e brendshme brenda insitucionit e që qëllim kanë pasur funksionimin sa më të mirë të insitucionit sepse mosfunksionimi si duhet I një mekanizmi të tillë do të rrezikonte sigurinë e përgjithshme dhe individuale të secilit qytetar të Kosovës.

Pretendimet rreth vërtetësisë së lajmit apo bashkëpunimi I brendshëm I të paditurës me mekanizëm të brendshëm mundet me qenë çështje apo interes për një procedurë tjetër dhe poashtu mund të vërtetojë brishtësinë e institucionit në raport me konfidencialitetin dhe sekretin e informatave të brendshme por që paditësi edhe këtë ka dështuar që ta provojë në këtë procedurë. Mediat dhe gazetarët si synim e kanë informimin e publikut dhe atë në kohë sa më të shpejtë dhe kjo nganjëherë përbën një shkarje në drejtim të vërtetimit të secilës informatë, pastaj pretendimi se secili informacion duhet të vërtetohet në detaje siç pretendon pala paditëse edhe në rast të tillë kur informacioni nuk jep të dhëna personale dhe marrja e informatave të brendshme është pothuajse e pamundur, publikimi I një informate të tillë përkon me interesin publik të informimit sepse mos informimi fare. Qytetarët kanë të drejtë të dinë se a ka ndonjë informacion zyrtar apo jo zyrtar nga ana e gazetarëve rreth dorëheqjeve të krerëve të institucioneve më vitale të Shtetit të Kosovës.

Aspektet tjera të pretenduara nga pala paditëse për dhimbje shpirtërtërore mund të qëndrojnë por me kusht që të vërtetohet baza, pra që të vërtetohet ekzistimi I shpifjes apo fyerjes, në të kundërtën të njëjtat janë jo relevante kur nuk ka vërtetim të elementeve të shpifjes apo fyerjes.

Me nenin 5 par.1 të Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes përcaktohet se: *“Një person është përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë se ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose*

fyerjes përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj.”

Me nenin 5 par.3 të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes përcaktohet se: *“Kur shpifja ose fyerja ka të bëjë me një çështje të interesit publik ose kur personi i shpifur ose fyer është ose ka qenë zyrtar publik ose është kandidat për një pozitë publike, mund të ketë përgjegjësi për shpifje ose fyerje vetëm nëse autori ka ditur se informacioni ka qenë i rrejshëm ose ka vepruar me mospërfillje të pamatur për vërtetësinë e tij.”*

Me nenin 2.1 të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes përcaktohet se: *“Ky Ligj do të interpretohet në mënyrën e cila siguron se aplikimi i dispozitave të tij e maksimalizon parimin e lirisë së shprehjes dhe do të jetë në pajtim me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, siç zbatohet në praktikën ligjore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*

Me nenin 182 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcaktohet se: *“Në rast të cenimit të së drejtës së personalitetit Gjykata mund të urdhërojë shpalljen e aktgjykimit, përkatësisht të përmirësimit me shpenzim të dëmtuesit, ose të urdhërojë që dëmtuesi ta tërheqë deklaratën me të cilën është bërë shkelja, ose diç tjetër me të cilën gjë mund të realizohet qëllimi që arrihet me shpërblim.”*

Me nenin 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcaktohet se: *“1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. - 13 - 2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësisë në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.”*

Me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcaktohet se: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshinë lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që tu kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen melicencë. 2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund tu nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokartike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rednit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënëve konfidenciale ose për të grantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësorë”.*

Sipas interpretimit të dispozitave të lartcekura bazës ligjore, kushtetues dhe të konventës, arrihet në përfundim se me të drejtë Gjykata e shkallës së parë ia ka refuzuar kërkesëpadinë paditësit, sepse nuk është vërtetuar fakti se shkrimi i adresohet paditësit, por kjo supozohet dhe aludohet nga vet paditësi, pastaj informacioni i publikuar nuk është përcaktuar se është shpifës e as me përmbajtje nënqmuese, ndërsa e paditura në drejtim të raportimit të së njëjti nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 5.3 të Ligjit Civilin kundër Shpifjes dhe Fyerjes sepse nuk është vërtetuar e ka ditur se informacioni është i rrejshëm e as që ka vepruar me pamatur për

vërtetimin e të njëjtit, madje interes i publikut për të mësuar të vërtetën e dorëheqjes së drejtorit të AKI-së apo arsyeve që kanë qar tek dorëheqja është interes I publikut, gjë që në përputhje me këtë interes ka vepruar edhe e paditura. Përmes një vendimarrje të tillë arrihet zbatimi I saktë I detyrimit që rrjedh nga neni 2.1 I Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, pasi në këtë mënyrë arrihet maksimizimi I parimit të Lirisë së Shprehjes në përputhje me Konventën Evropiane për te Drejtat e Njeriut dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në raport me shpenzime e procedurës drejtë ka vendosur Gjykata e shkallës së parë konform nenit 463 të LPK-së sepse pala e paditur nuk ka specifikuar shpenzimet andaj kërkesa për kompensim të shpenzimeve të pa specifikuar refuzohet si e tillë.

Gjykata ankimore i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat nuk janë me ndikim për një vendosje ndryshe nga ajo sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.899/2022, me datë 07.05.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Faton Ademi, d.v